

VENDIM
Nr. 731, datë 16.11.2022

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 645, DATË 1.10.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR NGRITJEN DHE MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË
KOMISIONIT TË ÇMIMIT TË BARNAVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 38, të ligjit nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 645, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “a”, të pikës 2, dhe në të gjithë përmbajtjen e këtij vendimi, emërtimi “Sektori i rregullimit të tregut farmaceutik dhe pajisjeve mjekësore” zëvendësohet me “Drejtoria e Politikave Farmaceutike dhe Pajisjeve Mjekësore”.

2. Paragrafi i dytë, i shkronjës “a”, të pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Sekretari i komisionit është një përfaqësues i sektorit të farmaceutikës, në Drejtorinë e Politikave Farmaceutike dhe Pajisjeve Mjekësore, në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë.”.

3. Paragrafi i parë, i pikës 17, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Struktura përgjegjëse në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, brenda datës 31 dhjetor të çdo viti, dërgon pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor listën e përgjithshme me çmimet “CIF/EXW”, të miratuar nga komisioni.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku